



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

179
20/09/20
12:10

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 25. 09. 2020

VENDIMNr. 84, datë 25. 09. 2020

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
"BACHELOR NË PËRKTHIM NË ANGLISHTE PËR QËLLIME TË POSAÇME"**

Mbështetur në neni 25, pika 7, neni 38 pika 1, shkronja dh, nenin 73, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 10, pika 6, neni 19, pika 1 shkronja ë të Statutit të Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14 .01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 25. 09.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja me shkresën nr. 266 prot., datë 15. 09. 2020 për çeljen e programit të ri të studimit të ciklit të parë "Bachelor në përkthim në anglishte për qëllime të posaçme".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola Agaraj

